

BIBLIOTEKA
SHTETIT

85H-1
Gj. 73

XHEBRO
GJIKA

ZEMRA
MË
KËNDON

poezi

$$\frac{DJH-1}{S_i + 5}$$

XHEBRO
GJIKA




ZEMRA

MÈ

KËNDON

MË KËNDON



12602

BIBLIOGRAPHY OF THE LITERATURE OF THE HUMAN SCIENCES AND THE ARTS
BIBLIOGRAPHY OF THE LITERATURE OF THE HUMAN SCIENCES AND THE ARTS
BIBLIOGRAPHY OF THE LITERATURE OF THE HUMAN SCIENCES AND THE ARTS

SHTËPIA BOTUËSE «NAIM FRASHËRI»

XHEBRO
GJIRJA



ZEMRA
ME
KENDON

boezi



Tirazhi 1500 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK – Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1979

DY FJALË

Sikur të kishite mundësi të ngjiteshim në kohë deri në burimet e këngëve të popullit, do të gjenim mes mjegullës së viteve e shekujve krijuesit e parë. Diku në një dushkajë, pas betejës, luftëtarët e lirisë duke lidhur plagët, në një brinjë mali çobani me halle shumë, pranë vatrës një nënë në të zeza, krushqit mes haresë e dramave të fshehura të dasmave, një djalë e një vajzë që ndoshta s'u takuan kurrë po që përjetësish i bashkoi dashuria e kështu qindra e mijëra njerëz të thjeshtë të punës e të pushkës i nxorën këngët nga zemra, kënduaqn për ato që panë, ndien e përjetuan e kënga kaloi ndër breza gojë më gojë duke u lëmuar, saktësuar e përsosur.

Një nga këta poetë modestë të popullit, që s'humbi si humbisnin dikur emrin duke lënë shpirtin e mendjen në vargje, është dhe Xhebro Gjika nga Tërbacë i Vlorës. Këngët e tij, ashtu si ato të Memo Metos, Selim Hasanit, Shefqet Peçit apo Sokol Arifit,

patën fatin e madh të hyjnë në gojën e popullit, sa sot, edhe pse nga shumëkush njihet autorë, është gati e pamundur t'i dallosh nga poezia e mirëfilltë popullore që ka fituar anonimatin.

Xhebro Gjika lindi në vitin 1900 dhe vdiq në kohët e së ardhmes. Ky rapsod, që s'i ndau kurrë nga veta pushkën e kërrabën, ka mbetur në kujtesën e bashkëfshatarëve, të miqve e të njohurve të shumtë, si mishërim i habit trim e hokatar, të shtruar e themrës, të qartë e besnik në çdo situatë, sulmues e shpontues ndaj kujtdu që prekte sadopak interesat e popullit e të Partisë. Thumbit të fjalëve e të vargjeve të tij s'i ka shpëruar as ai vetë. Jeta e gjallë, e pasur prej militanti s'kishte si të mos gurgullonte dhe në këngët e tij plot ngjyra e reflekse, të drejtëpërdrejta e të thjeshta, përherë aktuale e mbi të gjitha të ngjizura me partishmeri të thellë komuniste.

Në nekrologjinë e botuar në gazeten «Bashkimi», midis të tjerave thuhet: «Si rapsod popullor i ka kënduar më patos e dashuri popullit, Partisë e shokut Enver duke kontribuar kështu edhe në edukimin e brezit të ri».

Ne kemi një Parti, qëndrimi si që mëndop e
shqiponjë me katër sy, që sot
shikon larg dhe pa dylbi, që e nisur që
Këto vargje sa të thjeshtë aq dhe sugjesticiv, sa
kuptimplotë aq dhe emocionues, janë të pandarë
nga shumë këngë, të cilat kanë brendi politike të li-
dhur me përpjekjet për të ruajtur të pacënuar lirinë
e fitoret e arritura, për të forcuar pushtetin popullor,
për të çarë rrëthimin imperialisto-rezisionist.

Karakteri militant e fryma thëllësisht aktuale
duket edhe në qëndrimin e poetit popullor ndaj ar-
miqve të jashtëm e të brendshëm, ndaj tradhtarëve
apo birokratëve e liberalëve. Ja si e shpreh ai fun-
din logjik të armiqve:

Të gjithëve u dihet fundi
s'u mbetet nishan gjökundi,
treten posa tym katundi.

Ata që i kanë jetuar të dy kohët; të djeshtmen
e të sotmen, nuk mund të rrinë pa krahasuar, pa u
vënë përpara të rinjve kontrastin e fort: bardhë e
zi, pa treguar se ç'lufjtë e punë u desh e duhet për
të arritur këtu ku jemi e ku do të vemi të udhëhe-
qur nga Partia. Prandaj ky poet na çon shpesh edhe
brenda një kënge nëpër shtigjet e viteve të lara me
gjak e djersë. Duke kënduar për shtypjen e hallet

e popullit në të kaluarën, ai në radhë të parë këndon për shpirtin liridashës e luftarak të shqiptarit, për guximin e heroizmin e tij tradicional të manifestuar në betejat për liri, ekzistencë e përpërçim. Këtu e ka zanafillën ai rrëfim me kaq dashuri e krenari për trimat e Luftës së Vlorës, për dëshmorët e Luftës Nacionalçlirimtare, për Ushtrinë Popullore, etj. Krenaria e poetit është e shkrirë në një me krenarinë legjitime të popullit.

Në këtë libër janë përfshirë vetëm një pjesë e krijimeve të këtij rapsodi; shumë kanë mbetur në gojën e popullit e duhen qëmtuar, një pjesë ruhen në kujtesën e shokëve e të njohurve e duhen vjelë, disa kanë mbetur krijime të çastit, pa përpunimin e duhur të brumit e formës poetike, prandaj dhe janë lënë jashtë kësaj përbledhjeje.

Le t'i myllim këto dy fjalë me gjëzimin e rapsodit plak:

*Shqipëria mbet siç doli
një brigadë me luanë.*

PANDELI KOÇI

PËR PARTINË FAMËMADHE

O MATELLI E TABUSSIT

Do të dal të dredh një valle,
o Parti, moj famëmadhe!
Na erdhe si nur, u shfaqe
në ca streha, në ca lagje;
shkove u rrite në male
nëpër shpella, ilegale,
tre vjet luftë me dy krale
veshur me makinë të madhe.
Po ti dole yll me halle.
Timonin sa fort e mbaje
në rrugë pa xhade çave
buzë shkëmbit kurrë s'shkave;
tokën ti me gjak e lave
edhe dole fitimtare.
Pas Çlirimit, pas furtunës
të thamë — Parti e Punës.
Nga populli kurrë s'u ndave,
se dole nga flakë e madhe.
E argasura me halle,
rrite kaq lavdi të madhe!
Zemra jonë partizane.

e populatë me të kohave, në qafë vodhë të përdorur
don përmes shqiptarëve e kufijve te përgjithshme
për qytetin e Beratit, që tashmë është pjesë e komunës
Jestuar në brigjet e lindjeve, që përfshinë qytetin e përgjithshëm
Këtë mësimdhënës

O MALET E LABËRISË!

O malet e Labërisë!

Në luftën me dy armiqtë,
me fashistë e me nazistë,
u bëtë fole e Partisë,
konaku i vegjelisë,
sheshmejdani i trimërisë.
Enveri zemërçelik,
tok me shokë komunistë
i bënë thirrje rinisë
anembanë Shqipërisë.
Ngritën flamur e lirisë,
me gjak trimash të qendisë.

Kaqedeshi Shën Mihalit
I përgjigjet që mund t'i lëshoj
Seflerin Haxhi Kastrioti
I si gjyqja e kësaj...
E qëllë i qëndroj me
Në një shtëpi e vjetër
LUFTA E VLORËS
1920

Në Vlorë me histori rët e vjet
Eshtë lufta që ka bërë më shumë
më njëzetë me Itali u ndodh u
me ca të rrallë dyfekë
të rrëmbyer në Turqi,
ca sëpata dhe hanxharë
u derdhë mbi artileri.
Kush e njih Selam Musanë,
luftëtar si ai!
Zigur Lelon hanedanë,
ra në Kotë tek dha furi.
Toto Hosi, burrë i gjallë,
sulmoi, bëri kërdi!
Po Hodo Zeqir Dukanë,
mu si sorkadhi me bri!
E mori plumbi në ballë,
si luan për tokë u shtri.